



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

VENDIM NR 144 Datë 04.11.2020

"Për miratimin e faktit 6-mujor të buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2020"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në nenin 9 pika 1.3 shkronja "c", 18, 34, 40, 41, 54, shkronja "dh", 55 pika 3, kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, keu VII, nenet 39-41 të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 44, pika 4, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhmin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, VKM nr.620 datë 26.10.2018 "Për propozimin e projektligjit "Për buxhetin e vitit 2019", Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV". Udhëzimin plotësues nr.6/3 datë 10.07.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e buxhetit vendor" me anekset plotësuese, si dhe në ligjin nr.88/2019 datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020", i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.05 datë 29.01.2020, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.183/1 prot. datë 07.02.2020: Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e tij, vendosi me datë 04.11.2020 me 17 vota pro 1 vota kundër 1 vota apstenim.

VENDOSI :

1. Miratimin e realizimit të faktit 6-mujor të buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2020 sipas udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetar Këshilli
Sokol SAVA